



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/25

Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet e mbledhjeve: të 19-të dhe të 20-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: të 21-të, të 22-të, 23-të dhe të 24-t Elektronike\Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/25
Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike si dhe nenin 9 dhe 13 të Rregullores Nr. 03/2025 për Kushtet e Bartjes së Pronësisë së Pronës Publike dhe Dhënia me Qira e Sendeve në Pronësi Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet qiradhënia për sipërfaqen prej 99715 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1685079 m² e cilat gjenden në parcelën P-73317079-001116-0 zona kadastrale Seqisht, Komuna Hani i Elezit, sipas kërkesës nga Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kohëzgjatje prej 15 vite për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror.
2. Obligohet Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Operatori ekonomik, që brenda 30 ditësh të nënshkruajnë kontratën për dhënien me qira, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të gjitha institucionet kompetente sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Zyra për Administrimin e Pronës Publike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit me datë 22.06.2026 në mënyrë zyrtare përmes shkresës Protokoll Nr. 720 "Akti përcjellës i draft kontratës për OE Sharr Cem", ka pranuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kërkesën për marrjen e Vendimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike për lëshim me qira të sipërfaqen prej 99715 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1685079 m² të cilat gjenden në parcelën P-73317079-001116-0 zona kadastrale Seqisht, Komuna Hani i Elezit.

Për lëshimin me qira të kësaj hapësire Agjencia Pyjore e Kosovës ka përgatitur dosjen sipas legjislacionit në fuqi e cila ka përmbajtje të dhënat e Autoritetit kontraktues, të dhënat bazë për pronën ku përfshihet lokacioni, sipërfaqja e propozuar për qira, destinimi aktual dhe ai i propozuar për qira, numrin e parcelës, dokumentet e pronësisë, kohëzgjatjen e qirasë për 15 vite si dhe vlerën e qirasë vjetore për këtë kategori.

Me datë 24.02.2026 Zyra për Administrimin e Pronës Publike ka pranuar shkresën me nr. Prot 147 dhe plotësuar me dosjen nr. Prot 147/287 datë 05.03.2026 në ZKM me subjekt kërkesë "Kërkesë për marrje të pëlqimeve paraprake", pjesës së parcelës nr. P-73317079-001116-0 në Zonën Seqishtë, Komuna Hani i Elezit me sipërfaqe prej 99715 m² nga sipërfaqja e përgjithshme 1685079 m² me qëllim: Nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Tutje, për shqyrtimin e kërkesës është zbatuar neni 10, paragrafi 2, i Rregullores Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e ZAPP-se në Zyrën e Kryeministrit, mirëpo u vërtetua se asnjë institucion tjetër nuk ka interes publik për atë pronë.

Pas inspektimit në terren nga zyrtarët e ZAPP-së, dhe konstatimit se këto hapësira shfrytëzohen për të njëjtin qëllim siç edhe janë propozuar të jepen me qira, me datë 30.03.2026 prot.147/342 ZAPP lëshon Pëlqimin Parimor në pajtim me Vendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me nr. 2169 datë 20.09.2024.

Tutje, janë zhvilluar procedurat sipas legjislacionit në fuqi nga Agjencia Pyjore e Kosovës, dhe në Qershor 2026 ka përpiluar draft kontratën me titull "Kontratë për qiranë e tokës pyjore", për sipërfaqen 99715 m² në kohëzgjatje 15 vite mbështetur në nenin 6, pika 5, e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2025 që për secilën m² të sipërfaqes së marrë me qira të paguaj Agjencisë Pyjore të Kosovës 0.10 euro/m²/vit dhe obligimi për pyllëzimin e sipërfaqes së njëjtë të marrë me qira dhe mirëmbajtje për 3 vjetorin e parë të mbjelljes së fidanëve. Kushtet, mënyra e pyllëzimit dhe lokacioni përcaktohet nga Agjencia.


Për sipërfaqen prej 99715 m²*0.10 cent/vit*15vite=149,572.50€.

Duke marrë parasysh arsyetimin u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë administrative. Palët e pakënaqura mund të paraqesin padi për inicimin e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Administrative të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej 30 tridhjetë ditësh, pas publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/25
Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 4, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve në shumë prej: 1,150,000.00€ (një milion e njëqindpesëdhjetë mijë euro), në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit me kod 205, nënprogrami projektet e bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale me kod 42000, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti kapital "Programi i Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale" me kod 10041 në 4 (katër) projekte kapitale të reja në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit dhe kryetarët e komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti kapital: "Programi i Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale" me kod 10041 në këto projekte të reja, në pajtim me shumat e cekura si në vijim:
 - 2.1. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutllovc dhe Vllahi, Komuna e Mitrovicës së Jugut, alokimi për vitin 2026 në vlerë 500,000€;
 - 2.2. Rehabilitimi i rrugës së Uglarit, segmenti i rrugës "Agron Rrahmani" Komuna e Fushë Kosovës dhe Graçanicës, alokimi për vitin 2026 në vlerë 200,000€;
 - 2.3. Rehabilitimi, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës që lidh Plemetin, Hamidinë dhe Sibocin, Komuna e Obiliqit, alokimi për vitin 2026 në vlerë 300,000€;
 - 2.4. Ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemit të ndriçimit publik në Komunën e Obiliqit, alokimi për vitin 2026 në vlerë 150,000€.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/25

Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 13, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve në shumën prej: 1,050,000.00€ (një milion e pesëdhjetë mijë euro), në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me kod 212, nënprogrami Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, konkretisht nga projekti kapital "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socioekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal" me kod 15633 në 4 (katër) projekte kapitale në përputhje me 4 (katër) marrëveshjet për mbështetje financiare për projektet kapitale të nënshkruara nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarët e komunave përkatëse.
2. Mjete nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti kapital "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socioekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal" me kod 15633 për 4 (katër) projekte të reja:
 - 2.1. Projekti "Rekonstruimi i urës Sitnica", Komuna e Mitrovicës së Jugut, në vlerë prej 400,000.00€;
 - 2.2. Projekti "Rregullimi i kanalizimit dhe asfaltimi në qytet: "Rr Enver Gashi", "Rr Sami Frashëri" dhe fshatra të tjera në Komunën e Shtimes", Komuna e Shtimes, në vlerë prej 300,000.00€;
 - 2.3. Projekti "Rivitalizimi i zonave publike dhe infrastrukturës së rekreacionit malor", Komuna e Pejës, 300,000.00€;
 - 2.4. Projekti "Ndërtimi i sallës së jashtme sportive në shkollën "Musli Dumoshi" në Dumosh" Komuna e Podujevës, në vlerë prej 50,000.00€.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/25
Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 44, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet ekzekutimi i Rregullores për pranimin dhe trajtimin e thirrjeve telefonike në sistemin e caktimit të avokatëve, sipas detyrës zyrtare (ex-officio) të Odës së Avokatëve të Kosovës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente.
2. Obligohet Oda e Avokatëve të Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 6 të Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, ndërlidhur me Ligjin Nr. 04/L-193 për Avokatinë, ushtron përgjegjësinë për zhvillimin e politikave që garantojnë funksionimin e rregullt dhe efektiv të sistemit të drejtësisë, institucioneve të tjera të pavarura në fushëveprimtarinë e drejtësisë, si dhe qasjen e barabartë në mbrojtje juridike për të gjithë qytetarët.

Në kuadër të ushtrimit të këtij mandati dhe bashkëpunimit ndërinstitutional me organet e sistemit të drejtësisë, janë identifikuar çështje të ngritura nga institucione të ndryshme të zbatimit të ligjit dhe palë të tjera relevante, lidhur me zbatimin e Rregullores për pranimin dhe trajtimin e thirrjeve telefonike në sistemin e caktimit të avokatëve, sipas detyrës zyrtare (ex-officio) të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Sipas informatave të pranuar nga institucionet kompetente, janë evidentuar vështirësi në funksionimin praktik të sistemit të caktimit të mbrojtësve sipas detyrës zyrtare, të cilat mund të ndikojnë në efikasitetin e garantimit të mbrojtjes juridike në faza të caktuara të procedurës penale.


Në këtë kontekst, caktimi i mbrojtësit sipas detyrës zyrtare përbën element thelbësor të së drejtës për mbrojtje në procedurë penale, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale, si dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Nga analiza e dispozitave të rregullores së lartcekur, është vlerësuar se disa nga kërkesat procedurale të parapara në të, mund të krijojnë pengesa praktike në zbatimin efektiv të mekanizmit të caktimit të mbrojtësit sipas detyrës zyrtare, veçanërisht në fazat fillestare të procedurës penale, kur të dhënat relevante mund të mos jenë plotësisht të disponueshme.

Duke marrë parasysh rëndësinë e garantimit të mbrojtjes juridike efektive dhe nevojën për funksionim të pandërprerë të sistemit ex-officio, është vlerësuar e nevojshme që zbatimi i rregullores së lartcekur të pezullohet përkohësisht deri në vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente.

Andaj, duke i pasur për bazë arsyetimin e lartcekur, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/25
Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 44, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet ekzekutimi i aktit administrativ mbi lartësinë e shpenzimeve për regjistrim të Odës së Avokatëve të Kosovës, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës kompetente.
2. Obligohet Oda e Avokatëve të Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 6 të Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, ndërlidhur me Ligjin Nr. 04/L-193 për Avokatinë, ushtron përgjegjësinë për zhvillimin e politikave që garantojnë funksionimin e rregullt dhe efektiv të sistemit të drejtësisë, institucioneve të tjera të pavarura në fushëveprimtarinë e drejtësisë, si dhe qasjen e barabartë në mbrojtje juridike për të gjithë qytetarët.


Në kuadër të ushtrimit të këtij mandati dhe bashkëpunimit ndërinstitutional me institucionet e sistemit të drejtësisë, janë evidentuar shqetësime të ngritura nga palë të ndryshme dhe nga praktika institucionale, lidhur me zbatimin e skemës së shpenzimeve për regjistrim në Odën e Avokatëve të Kosovës.

Ministria e Drejtësisë, në pajtim me nenin 44 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, ka përcjellë punën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe pas analizimit të lartësisë së shpenzimeve për regjistrim të nxjerrë nga Oda e Avokatëve të Kosovës, konstaton se lartësia e shpenzimeve të përcaktuara për regjistrim, tejkalon kufirin ligjor të përcaktuar në nenin 7, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, sipas të cilit shpenzimet e regjistrimit nuk mund të jenë më të larta se tri (3) paga minimale në Republikën e Kosovës.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/273, të datës 31.10.2025, për përcaktimin e pagës minimale, e cila nga 01.01.2026 është 425.00€, respektivisht nga 01.07.2026 është 500.00€, rezulton se kufiri ligjor i lejuar për shpenzimet e regjistrimit nuk mund të tejkalohet mbi këtë bazë të përcaktuar.

Andaj, duke pasur për bazë arsyetimin e lartcekur, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/25
Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Qerim Ademaj, Kryetar i Komisionit;
 - 1.2. Znj. Adelina Berisha, anëtare;
 - 1.3. Z. Ramadan Halimi, anëtar.
2. Mandati i Kryetarit të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, sipas pikës 1.1 të këtij Vendimi është katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër, ndërsa mandati i anëtarit të Komisionit, sipas pikës 1.3 të këtij Vendimi, është tri (3) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.
3. Me këtë Vendim shfuqizohen të gjitha vendimet për emërimin e Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, me përjashtim të Vendimit Nr. 02/197, të datës 29.03.2024, me të cilin znj. Adelina Berisha është emëruar anëtare e Komisionit.
4. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij Vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë t'i kryejë në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
5. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/25
Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13, paragrafit 4, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve në shumë prej 350,000.00€ (treqind e pesëdhjetë mijë euro) në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me kod 221, nënprogrami Administrata Qendrore me kod 11321, nga kategoria e investimeve kapitale, konkretisht nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782, në tetë (8) projekte të investimit kapital në pajtim me Marrëveshjet e Mirëkuptimit për bashkëfinancim të projekteve të nënshkruara nga Ministri i Zhvillimit Rajonal dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti i investimit kapital "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782, në këto projekte, me shumat e cekura si në vijim:
 - 2.1. "Rikonstruimi i shtresës së asfaltit të rrugës që lidhë fshatrat Reshtan – Semetisht – Breshanc dhe Nishor", Komuna e Suharekës, në shumë prej 40,000.00€;
 - 2.2. "Ndërtimi i ndriçimit publik në fshatin Vitomiricë, Zllapek, Ruhot, Nakull, Poqest dhe Katun i Ri", Komuna e Pejës në shumë prej 40,000.00€;
 - 2.3. "Ndërtimi i sallës së sporteve në Komunën e Junikut", Komuna e Junikut, në shumë prej 50,000.00€;
 - 2.4. "Rregullimi i parkut në Petrovë", Komuna e Shtimes, në shumë prej 40,000.00€;
 - 2.5. "Rregullimi i parkut urban në lagjen Dardania në Prizren", Komuna e Prizrenit, në shumë prej 40,000.00€;
 - 2.6. "Rivitalizimi i hapësirave agroturistike dhe trajtimi i peizazhit Rural", Komuna e Rahovecit, në shumë prej 50,000.00€;
 - 2.7. "Shtigjet e ecjes në Komunën e Vushtrrisë", Komuna e Vushtrrisë, në shumë prej 40,000.00€;
 - 2.8. "Krijimi dhe renovimi i stacioneve dhe vend pritjeve për autobus të transportit publik të udhëtarëve", Komuna e Gjakovës" në shumë prej 50,000.00€.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/25

Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit: Sanimi i Rrëshqitjes në rrugën Hani i Elezit - Gorancë, zona kadastrale: Rezhancë, Komuna e Hanit të Elezit, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Departamenti për Infrastrukturë Rrugore (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit) dhe Ministria e Financave.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/25

Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit Rehabilitimi i rrugës Rajonale R112, segmenti: Gjonaj - Bishtazhin, zona kadastrale: Gjonaj, Komuna e Prizrenit, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknikë të vlerësimit, që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit, do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Departamenti për Infrastrukturë Rrugore (Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit) dhe Ministria e Financave.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/25
Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/1-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenin 13, paragrafi 1, të Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 200,000.00€ (dyqind mijë euro), për financimin e furnizimit dhe instalimit të një gjeneratori të ri në Burgun e Sigurisë së Lartë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga programi "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 232, nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", projekti "Shpenzimet e Paparashikueshme", me kod 13255, dhe transferohen në Ministrinë e Drejtësisë, me kod 215, në nënprogramin "Shërbimi Korrektues i Kosovës", me kod 33600, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale", në kuadër të projektit kapital "Shpenzimet Emergjente (intervenimet në sistemin e ujit, rrymës, ngrohjes dhe intervenimet e tjera në raste emergjente)", me kod 10210.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/25
Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve në shumën prej 12,513.00€ (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë euro), të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, për Ndërmarrjen Shoqërore "Komogllava".
2. Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimit të këtyre të hyrave nga llogaria kryesore e Fondit të Republikës së Kosovës dhe kthehen në llogarinë e ndërmarrjes shoqërore sipas pikës 1. të këtij Vendimi, me qëllim që ndërmarrjet shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat kreditore apo për të mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/25

Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/-I-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për KOMPAS - Projekti i Qasjes Gjithëpërfshirëse të Kosovës për Forcimin e Sistemit Shëndetësor.
2. Obligohet Ministria e Financave për ndërmarrjen e hapave në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/25

Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 1, si dhe nenit 43, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Infrakos" Sh. A., në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Getuar Zogu, kryesues;
 - 1.2. Znj. Detrina Alishani - Sopi, anëtare;
 - 1.3. Znj. Fjolla Gashi, anëtare;
 - 1.4. Z. Genc Hundozi, anëtar.
2. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike zgjat gjashtë (6) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/25

Datë: 24.06.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24, paragrafët 1, dhe 2, të Ligjit Nr.10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 44,004.22€ (dyzet e katër mijë e katër euro e njëzet e dy centë) për Komunën e Shtimes, për përfundimin e projektit "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza, Shtime", përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Iluamarrja për projekte potenciale brenda MFPI", me kod 48900, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", nga projekti "Kontigjenca për Klauzolë të Investimeve" me kod 15045, dhe transferohen në Komunën e Shtimes (617), në nënprogramin "Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik - Shtime" me kod 48007, në projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza, Shtime" me kod 49126, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" - përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06).
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Komuna e Shtimes për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/25

Datë: 24.06.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 2, të Ligjit Nr.10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178 të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178 të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241 të datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr.02/270 të datës 07.10.2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumën prej 3,000,000.00€ (tre milionë eurosh) për zbatimin e Masës 4.5 "Mbështetja e Mërgatës" të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet buxhetore në vlerë prej 3,000,000.00€ (tre milionë eurosh), merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Kontigjencat në Ministrinë e Financave" me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në nënprogramin "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave me kod 201, në nënprogramin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Autorizohet Ministria e Financave që, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të nënshkruajë Memorandumin e Bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Byronë Kosovare të Sigurimit, në pajtim me fushat e përgjegjësisë institucionale, për mbulimin e plotë të obligimeve të primit të sigurimit kufitar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për automjetet që janë subjekt i policës kufitare dhe hyjnë në Republikën e Kosovës deri në fund të vitit 2026, sipas përkufizimeve të përcaktuara në Memorandumin e Bashkëpunimit.
5. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë